

Partneritetet Publiko Private për Zhvillimin dhe Ndërtimin e Hidrocentraleve të Vogla

Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) e Republikës së Kosovës më 31 mars 2010, ka lëshuar Kërkesën për Kualifikim (KPK) për Zhvillimin dhe Operimin e Hidrocentraleve të Vogla. Kjo kërkesë është lëshuar, në emër të Komitetit Drejtues Ndërmintor të Projektit për Partneritetin Publik dhe Privat (KDN-PPP), në përputhje me Ligjin e Kosovës Nr. 03/L-090 për Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënien e tyre.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-090 procedurat e prokurimit do të zhvillohen në dy faza, Kërkesa për Kualifikime (KPK) dhe Kërkesa Për Propozime (KPP). Pas fazës së kualifikimeve Operatorët ekonomik të kualifikuar pastaj do të ftohen që të parashtrajnë propozimet e tyre për kontratën Projektim-Ndërtim-Financim-Operim-Bartje (PNFOB), në përputhje me Kërkesën për Propozim (KPP).

Ky projekt është inicuar nga Ministrja e Energjisë dhe Minierave znj. Justina Pula, e cila është anëtare e Komitetit Drejtues Ndërmintor të Projektit, ku poashtu marrin pjesë edhe Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë si dhe pwrfaqwsuesi i Zyrws sw Kryeministrit.

Resurset kryesore energjetike të Kosovës janë vendburimet e konsiderueshme të linjtit. Kosova nuk ka burime tjera të lëndëve fosile dhe ka potencial modest hidroenergjetik të cilin është e interesuar ta zhvillon në tërësi. Kosova aktualisht prodhon vetëm 3% të energjisë elektrike bazuar në burimet e ripërtrishme (uji), kurse 97% të tjera bazohen në djegien e linjtit në termocentrale.

Kosova aktualisht prodhon vetëm 3% të energjisë elektrike bazuar në burimet e ripërtrishme(uji), kurse 97% të tjera bazohet në djeien e linjtit në termocentrale.

Hidro potenciali energjetik i tërsishem në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 0.7TWh/vit.

Ministria e Energjisë dhe Minierave ka propozuar fillimin e procesit të PPP-së së pari me 11 hidrocentrale të vogla ("HCV") të ndara në tetë (8) lote të listuar më poshtë:

1. Lumi Lumbardhi I Lloçanit- 1 HCV

HCV Lloqan(950-700), me rënie rreth 250 m, prurje llogaritëse rreth 1.5 m³/sek, fuqi rreth 3100 kW dhe prodhim mesatar shumëvjeçar rreth 14 milion kWh/vit.

2. Lumi Erenik-3 HCV

A.HCV MAL(1000-800) me rënie rreth 200 m, prurje llogaritëse rreth 2.4m³/sek, fuqi rreth 4000 kW dhe prodhim mesatar shumëvjeçar rreth 18 milion kWh/vit.

B.HCV ERENİK(800-700) me rënie rreth 100m, prurje llogaritëse rreth 2.4m³/sek, fuqi rreth 2000kW dhe prodhim mesatar shumëvjeçar rreth 9 milion kWh/vit.

C. HCV JASIQ(700-610) me rënie rreth 90m prurje llogaritëse rreth 2.6m³/sek, fuqi rreth 1900kW dhe prodhim mesatar shumëvjeçar rreth 9.7 milion kWh/vit.

3. Lumi Lumebardhi I Prizrenit- 1 HCV

HCV Reçan(670-600) me rënie rreth 70m, prurje llogaritëse rreth 2.6m³/sek, fuqi rreth 1500 kW dhe prodhim mesatar shumëvjeçar rreth 6.7 milion kWh/vit.

4. Lumi Lepenc- 2 HCV
 A.HCV I Shtërpces(890-830) me rënie rreth 60 m, prurje llogaritëse rreth 4.5 m³/sek, dhe fuqi rreth 2100kw dhe prodhim mesatar shumëvjeqar rreth 10 milion kwh/vit.

 B.HCV I Lepencit(640-580) me rënie rreth 60 metra prurje llogaritëse 7.6 m³/sek, fuqi rreth 3500kw, dhe me prodhim mesatar shumëvjeqar rreth 16 milion kwh/vit.
5. Lumi Bajskws-1 HCV
 HCV-Bajskw(705-620)(Kamenicë) me rënie rreth 85 m, prurje llogaritëse 0.5 m³/sek, me fuqi rreth 300 kë dhe prodhim mesatar shumëvjeqar rreth 1.4milion kwh/vit.
6. Lumi I Perroi I Bistrices- 1 HCV

 HCV Batare(540-480)me rënie rreth 60m, me prurje llogaritese rreth 2.3m³/sek, me fuqi rreth 1100 kw dhe me prodhim mesatar shumëvjeqar rreth 5.8 kwh/vit
7. Lumi Rajoni I Llapit(Pwrroi i Kaqandollit) -1 HCV

 HCV I Majancit(610-560) me rënie rreth 50 m, prurje llogaritëse rreth 1.5m³/sek, me fuqi rreth 600 kw dhe me prodhim shumëvjeqar rreth 2.9 milion kwh/vit.
8. Lumi Drini i Bardhw - 1 HCV

 HCV i Mirushws(365-35) me rënie rreth 15 m, prurje llogaritëse rreth 45m³/sek, me fuqi rreth 4600 kw dhe prodhim mesatar shumëvjeqar rreth 22milion kwh/vit.

Zhvillimi i Projektit do të pwrqwndrohet më së pari në ofrimin e energjisë së pikut dhe rezervës së sistemit, dhe së dyti në shfrytëzimin ekonomik të resurseve ujore përmes këtij eksportimi të energjisë drejt tregjeve rajonale.

STRUKTURA E PROJEKTIT		
Struktura e Kontrata: Projekto- Ndërto-Financo-Opero-Bart		
Kohëzgjatja: 40 vite.		
Operatori do të projekton të gjitha aspektet ekonomike ,si dhe do të ndwrtoj, operoj dhe menaxhoj hidrocentralet e vogla.		
Minimumi i kapaciteteve të gjenerimit të energjise të kërkuaara për Llote:		
LOT11: 3100 kw (3.1 MW)	LOT14: 5600 kw (5.6 MW)	LOT17: 600 kw (0.6 MW)
LOT12: 7900 kw (7.9 MW)	LOT15: 300 kw (0.3 MW)	LOT18: 4600 kw (4.6 MW)
LOT13: 1500 kw (1.5 MW)	LOT16: 1100 kw (1.1MW)	TOTALI: 24700 kw (24.7 MW)